

MA Ruzhdi PANXHA

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

BURIME ARKIVORE PËR THEMELIMIN DHE ROLIN E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT, 1878-1881

Abstrakt: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (10 qershor 1878), vitet e Lidhjes 1878-1881, kanë një rëndësi vendimtare për historinë moderne shqiptare. Gjatë këtyre tre vjetëve lindi një lëvizje kombëtare shqiptare, për herë të parë ne opinionin publik e evropian (pas Skënderbeut) që u bë i vetëdijesim për ekzistencën e çështjes shqiptare. Rolë dhe rëndësia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, sot e kësaj dite mbete një hallkë e fuqishme në vertikalen historike shqiptare, e sidomos në filltet e artikulimit të Projektit për bashkimin e Vilajeteve Shqiptare në një tërësi të vetme autonome. Procese të kohës (krijimi i shteteve) nëpër të cilat kalonte i rajoni dhe vendet evropiane. Ky studim ka si qëllim të paraqesë rolin dhe rëndësinë primare jo vetëm të dokumenteve të botuara deri me sot nga arkivat e ndryshme, por edhe nevojën për hulumtime të mëtejshme për të parë dritën dokumentet e shumta që gjinden nëpër arkiva të ndryshme që flasin për këtë ngjarje të rëndësishme.*

Fjalë kyçe: *Burimet arkivore në dokumentet nga arkivat Vjenës (Österreichisches Staatsarchiv), Stambolli (Başbakanlık Arşivi), Parisit (Archives Nationales), Londrës (The National Archives), Romës (Archivio del Ministero per gli Affari Esteri di Roma).*

Lidhja e Prizrenit është një ngjarje e madhe, që lindi në kohën e Krizës Lindore, ndërsa për shqiptarët ajo konsiderohet si njëra nga ngjarjet më të rëndësishëm të periudhës historike moderne. Në këtë aspekt, për këtë ngjarje historike është shkruar bukur shumë jo vetëm në historiografinë shqiptare, por edhe në atë ballkanike dhe evropiane. Megjithatë, nga këndvështrimi i sotëm, mund të thuhet me plotë gojë se ende ruhet lënda e fshehur nëpër arkiva, e cila është publikuar pjesërisht. Ndërsa pjesa më e madhe e lëndës arkivore evropiane e osmane ende nuk e ka parë dritën e publikimit. Veçanërisht duhet përmendur këtu fondet e arkivave të Vjenës (Österreichisches Staatsarchiv), Stambollit (Başbakanlık Arşivi), Parisit (Archives Nationales), Londrës (The National Archives), Romës (Archivio del

Ministero per gli *Affari Esteri di Roma*), e ndonjë arkivi tjetër.¹

Dokumentet diplomatike, të cilat dolën në dritë nga zyrat e Fuqive të Mëdha, si, bie fjala, Britania e Madhe, Austro-Hungaria, Italia, Franca, Rusia e ndonjë tjetër, fuqi këto që kishin interesa gjeo-strategjike për Shqipërinë dhe Ballkanin. Është e njohur se Britania e Madhe kishte konsiderata të mëdha për Ballkanin, meqë nëpër këtë trevë do të kalonte shumë më shkurtër, respektivisht shumë më shpejtë për në Lindjen e Afërme, të Mesme dhe të Largët. Interesim për Ballkanin në kohën e Lidhjes së Prizrenit kanë shfaqur edhe Gjermania, e cila synonte nëpërmjet të programit “*Drang nach Osten*”, që t’i forconte pozitat e veta në Ballkan, dhe prej këndej në Lindjen e Afërme, të Mesme dhe të Largët. Po kështu, në ndarjen e sferave do të marrin pjesë Auatro-Hungaria, Franca, Rusia dhe Italia. Britania e Madhe, Franca dhe Rusia bënë mes vete ndarjen e kolonive dhe të sferave të interesit. Në anë tjetër, Austro-Hungaria, Gjermania dhe Italia u vonuan në ndarjen e kolonive dhe të sferave të interesit, shkak ky pothuajse themelor për tu inkuadruar në garë, sidomos nga gjysma e dytë e shek. XIX për rindarjen e kolonive dhe të sferave të interesit. Brenda këtij kuadri gjithsesi duhet parë edhe çështjen shqiptare, e cila asnjëherë deri atëherë nuk ishte lidhur aq ngushtë ideologjikisht dhe politikisht me të drejta kombëtare të popujve dhe në mënyre të veçantë me të drejtën e popujve për të formuar secili shtetin vet. Në emër të këtij parimi ishin vënë në lëvizje diplomatët e Fuqive të Mëdha, si dhe penat publicistike evropiane dhe, në mënyre të veçantë, pena publicistike ballkanike. Në shumicën e tyre dërrmuese, të dy palët mbanin qëndrim nihilist ndaj të drejtave kombëtare shqiptarëve, çështje kjo që mund të ilustrohet edhe nga konsullatat e shteteve respektive të vendosura në qendra të njohura shqiptare të kohës. Kështu, konsulli Austro-hungarez në Prizren Jelinek, që më 30 prill

¹ Dokumentet diplomatike italiane filluan të hulumtohen nga prof. Nexhat Begolli dhe ndonjë tjetër ç’prej kapërcyellit të vitit 1976. Si të tilla shumë fonde nga hulumtimi në fjalë, sot ruhen në Arkivin Shtetëror të Kosovës: “*Rapporti in arrivo-Turchia*”, “*Questione Albanese*”, si dhe publikimi i dokumenteve italiane, “*I documenti diplomatici*”, e ndonjë tjetër. Në këtë kuadër janë të njohura edhe publikimet nga arkivat e Londrës, si, Skender Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente Angleze, 1878-1881* (Prishtinë: Arkivi i Kosovës, 1978), 1-323. Në Arkivin Shtetëror të Vjenës janë të njohura shumë fonde, në të cilat mund të zbulohet periudha e Lidhjes në kontekstin Austro-hungarez: “*Politisches Archiv*”, “*Konsulaté*”, si ajo me seli në Tivar, Shkodër, Prizren, Manastir, Selanik, etj. Krahaso për këtë, St. Antolak. *Lidhja e Prizrenit në dritën e lëndës arkivore në Vjenë dhe në Romë*, in: Ali Hadri (ed.), *Konferenca shkencore e 100-Vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, vëll. I, (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 1981), 351-357; Bogumil Hrabak, *Prizrenska Arbanaška Liga, 1878 -1881* (Beograd: 1998), 7-69. Është e njohur se dokumente austriake, britanike, frënge, italiane e osmane kishin filluar të publikohen më me shumicë vetëm në vigjilien e shënimit të 100-Vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. HOLLËSISHT PËR RËNDËSINË E BURIMEVE FRËNGE DUHET PARË NË: Archives du Ministère des Affaires Étrangères, Paris 1878-1881 (konsullata e Francës në Shkodër), citimi sipas, Gjyltekin Shehu. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente diplomatike franceze: (1878-1881)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë në Prishtinë-Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2010).

1878 kishte informuar për Marrëveshjen preliminare ruso-osmane dhe ndikimet e saj edhe në Sanxhakun e Prizrenit dhe më gjerësisht ku organizoheshin lëvizje dhe mbaheshin kuvende të mëdha për tu arritur konsensusi rreth territoreve shqiptare, të cilat ishin dhënë shteteve fqinjëve.² Diplomati Jelinek besonte se vetëm trupat austro-hungareze do të mund ta vendosin rendin dhe sigurinë në Kosovë. Nga ky komunikim, ndonjë studiues mendonte se, Austro-Hungaria po shfaqte pretendime, që lëvizjen shqiptare të shfrytëzonte për të shtrirë ndikimin e saj edhe në Kosovë. Karshi qëndrimeve të këtilla nuk mbetën pa reaguari opinioni dhe intelektualët shqiptarë. Kështu, që nga fillimet e muajit prill, Pashko Vasa i kishte dorëzuar ambasadorit britanik në Stamboll një Memorandum kundër vendimeve të Paqes së Shën Stefanit. Memorandumin në fjalë ambasadori britanik Layard e shoqëronte me këto fjalë: “Ky dokument do të jetë në gjendje të provojë më shumë për rrezikun, që vjen nga inkurajimi i dhënë popullsisë të ndryshme të Perandorisë Osmane, që nëpërmjet “autonomisë” të shohin kurimin nga të gjitha problemet që mund të kenë. Shqiptarët tani konsiderohen të kenë të drejtën e institucioneve vetëqeverisëse dhe pavarësinë e vërtetë [...]”. Informuesi im më tha se bashkatdhetarët e tij kurrë nuk do të pushojnë se agjituari dhe do të luftojnë derisa ta çlirojnë vendin e vet nga bullgarët, të cilët i konsiderojnë si racë shumë më inferiore. Shqiptarët e besimit islam dhe të krishterë do të bashkohen për këtë qëllim, dhe do të bëjnë aleancë me grekët për ta kundërshtuar depërtimin e sllavëve”. Memorandumi i Pashko Vasës pasqyron jo vetëm vizionin e intelektualëve shqiptarë lidhur me situatën në të cilën gjendet Porta, por edhe për këmbënguljen e shqiptarëve për të drejtat e tyre. Layard përmbyll raportin me fjalët: “Autonomia”, ndoshta nuk do të jetë ilaç i vërtetë për të shëruar armiqësitë sektare.”³ Jelinek, konsull Austro-Hungarez në Prizren, na ka lënë edhe njoftime me interes shkencor, që datojnë një javë pas mbajtjes së Kuvendit themelues të Lidhjes së Prizrenit (më 18 qershor 1878). Aty ishin ftuar burra të shquar të fiseve të njohura, delegatë nga Hercegovina, Sanxhaku, Shqipëria Jugore e Veriore, Maqedonia, Epiri dhe Tesalia. Diskutimet ishin përqendruar kryesisht mbi të ashtuquajturën, Kriza Lindore dhe në këtë kontekst edhe për interesat e të gjitha strukturave fetare shqiptare. Duke shpjeguar rreth arsyet e themelimit të Lidhjes së Prizrenit konsulli Jelinek theksonte se, “Lidhja është formuar nga populli [...], por impulsi parë i agjitacioneve për krijimin konkret të Lidhjes si organizatë erdhi nga qeveria angleze [...]. Në rast të luftës

² Aktenstücke aus den Korrespondenzen des *Kais. und Kön. Gemeinsamen Ministeriums des Äußern über orientalische Angelegenheiten* (Wien: Vom 7. April 1877 bis 3. November, 1878), 95-96, dok.147, 148.

³ Skënder Rizaj, *Dokumente Angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e optimit të Ballkanit: (1877-1885)*, Libri I (Prishtinë: Ndërmarrja botuese Rilindja, 1996), 53-54, dok. 7

me rusët, anglezët kanë siguruar para, armë dhe municion”.⁴

Në gjysmën e vitit 1880 konsulli Green, i cili kishte përkrahur përpjekjet e Lidhjes në Shkodër, i zhgënjyer kishte informuar diplomatët për shuarjen e Lidhjes në Malësi të kufiri me malazezët, pastaj në Gjakovë, Pejë dhe në gjithë Kosovën. Lidhur më çështjen në fjalë Green, mes tjerash shkruante kështu: “Porsa u dëgjua se Marrëveshja e Shën Stefanit nuk ishte marrëveshje definitive, Lidhja Shqiptare [...], kaloi në harresë, dhe vetëm në prag të mbledhjes së Kongresit të Berlinit Hysen Pasha, aso kohe vali i Shkodrës, mendoi për ringjalljen e saj, me qëllim që të kundërshtohet mbajtja e Ulqinit, e Tivarit dhe të krahinës së Krajës, nga Mali Zi, vende këto të cilat Principata e Malit të Zi i mori gjatë luftës me forcën e armëve [...]. Veprimtaria dhe zgjuarsia e Hysein Pashës i dha shpejtë zemër Nazif Pashës, valiut të Kosovës, në mënyrë që ta pranoj taktikën e njëjtë në vilajetin e vet për ta kundërshtuar zgjerimin e Serbisë, dhe së bashku e ftuan një farë Kuvendi të përfaqësuesve në Prizren, të cilët ishin kryesisht të emëruar nëpunës të valinjve, përfaqësues këta që u tubuan për një kohë të shkurtër”.⁵

Për situatën e krijuar me rastin e themelimit të Lidhjes është shprehur edhe Bernardo Berio, konsull italian në Shkodër, përndryshe simpatizues dhe përkrahës i shqiptarëve me të cilët llogariste se do ta pengonte depërtimin Austro-Hungarez në zemër të Ballkanit. Berio konsideronte se zgjedhja e Prizrenit për themelimin e Lidhjes do të gëzonte përkrahje edhe nga shumë vende të Evropës, meqë qyteti në fjalë ishte një qendër e njohur ushtarake dhe konsullore. Edhe pse Berio konsiderohet për përkrahës të korrjimit të kufirit në dobi të Malit të Zi, megjithatë ai kishte denoncuar ngushtimin e trojeve shqiptare sipas Paqes së Shën Stefanit, duke kërkuar edhe para themelimit të Lidhjes së Prizrenit që Evropa të angazhohet në mbrojtjen e tokave shqiptare. Është me interes të theksohet se po ky përkrahës i Lidhjes kishte vlerësuar negativisht programin e Lidhjes, si dhe zgjedhjen e Iljaz Pashë Dibrës për kryetar të saj.⁶

Franca, një mike tradicionale e Serbisë dhe Malit të Zi, nëpërmjet të konsullit Zhorzh Pons të vendosur në Shkodër përcillte me vëmendje situatën në terren, sidomos ishte i interesuar për çështjen e koncesioneve kufitare në dobi të Malit të Zi. Kështu, dy ditë pas themelimit të Lidhjes, shqiptarët e Podgoricës llogarisnin, që nëpërmjet të Lidhjes dhe diplomatëve të huaj do t'i

⁴ Haus-, Hof- und Staatsarchiv(Wien), Politisches Archiv XXXVII (Konsulat Prishtinë), Karton 225, Bericht, N°.11/ Pol., Prishtinë 18.VI 1878. Tubimin e ka konvokuar Kuvendi i përbërë prej 60 anëtarëve në krye më Iljaz Pashë Dibrën.

⁵ Skënder Rizaj. *Dokumente Angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e optimit të Ballkanit: (1877-1885)*, Libri II (Prishtinë: Ndërmarrja botuese Rilindja, 1996), 115, dok. 42.

⁶ Archivio Storico Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri (Roma), *seria Politica* 1867-1888.busta 219 (*Turchia*), N°2272, më 20/V/1878, nr.347; Krahaso. *I documenti diplomatici italiani*. Seconda serie 1870-1896, vol. X (Roma: 1976), 1/IV/1878.

adresojnë kërkesat e tyre në Kongresin e Berlinit.⁷ Madje, konsulli Pons ofronte edhe njoftime për protestën e shqiptarëve, ngatërresat në kufi me Malin e Zi, si dhe për nënshkruesit e Peticionit nga Shqipëria e Sipërme, të cilët kontaktuan edhe me përfaqësuesit zyrtarë të Shkodrës. Bëhet e ditur se katolikët ishin dakorduar me myslimanët për dëbimin e sllavëve nga trojet shqiptare, ndërsa gjykimi i studiuesit Hrabak se kërkesat politike të shqiptarëve romano-katolikë ishin të ndryshme nga ato që i propagandonte Lidhja nuk mund të mbështeten (siç mendonte ai) në vendburimin e konsullatës franceze në Shkodër.⁸ Kështu, çështja e themelimit të Lidhjes në Shqipërinë e Sipërme tashmë ishte akt i kryer: “Lidhja është formuar prej banorëve myslimanë të Shqipërisë së Sipërme, ajo është kundër çdo shkëputjeje [...]. Sot është i kryer, delegatët nga të gjitha distriktet janë mbledhur në Prizren dhe e përbëjnë Komitetin udhëheqës, disa prej tyre dëshirojnë t’i ruajnë privilegjet e Qeverisë së Portës”, është shprehur kështu z. Pons, konsulli francez në Shkodër më 15, 16, 17 qershor të vitit 1878.⁹

Konsulli francez në Shkodër gjithashtu njoftonte për themelimin dhe vendimet e Lidhjes, njoftime këto të cilat dolën më 14 korrik 1878, me të kthyer të delegatëve shkodranë nga Prizreni. Sipas z. Pons, Komiteti i Lidhjes kishte programin e vet, i cili kishte marrë vendime si vijon më poshtë: 1. Të formohet Komiteti qendror me seli në Prizren, i cili do të jetë mbikëqyrës; 2. Të formohen nënkomitetet në qendra të sanxhaqeve të Shqipërisë; 3. Të gjithë njerëzit që janë të shëndoshtë aftë për punë, së paku nga një për çdo shtëpi, duhet të marrin armët; 4. Sanxhaku i Shkodrës, duke përfshirë edhe Malësinë, duhet të furnizojë 30,000 luftëtarë; 5. Distriktet e Tiranës, Elbasanit, Ohrit do të grumbullonin 30,000 burra; 6. Përqendrimi i korpusit duhet të jetë: Prizreni, Peja, Kosova,

⁷ Gjyltekin Shehu. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente diplomatike franceze*, 27-28, dok. 6, 7, 8; Gjyltekin Shehu, *Aspekte të diplomacisë frënge përkitazi me Lidhjen Shqiptare (1878-1881)*, in: *Konferenca Shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, I, (Prishtinë: ASHAK, 1981), 265-269.

⁸ Gjyltekin Shehu. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente diplomatike franceze*, 24-25, 27-28, 31-32, dok. 2, 3, 7, 8, 12;

⁹ Gjyltekin Shehu. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente diplomatike franceze*, 31, dok. 11 (më 17/VI/1878): “Traktati i Shën Stefanit i mbajtur për rishikimin e kufijve, nga kabinetet e mbledhura në Kongres, i rrit Malit të Zi territoret në Shqipërinë Veriore, d.m.th. portat e Adriatikut, të Tivarit, dhe të Ulqinit, me kalatë dhe pozitat strategjike siç janë: Podgorica dhe Shpuza, të cilat i takonin gjithmonë këtij vendi dhe i shërbenin për mbrojtje kundër armikut [...]. Ne të nënshkruarit në emër të popullit ju lusim që t’i keni parasysh fatkeqësitë që i kërcnohen ekzistencës sonë. Kemi nderin të deklarojmë që kombi shqiptar, qoftë myslimanë qoftë katolikë nga raca e feja, krejtësisht dallohet nga sllavet, është unanimit në vendimin e tij që ta mbrojë atdheun e vet kundër ndarjes territoriale që e kanë projektuar në kundërshtim me historinë, interesat dhe dëshirat e tij. Ju lutem të mbroini integritetin tonë kombëtar dhe territorial, të na kurseni nga konfliktet e kobshme të cilat do të shpërthejnë nëse do të bënin aneksimin që e prekin Shqipërinë, ta na hapni rrugën e zhvillimit të cilën e dëshirojmë dhe të na bëni që ta ndiejmë influencën e kënaqshëm të civilizimit”; cfr. Shehu, *Aspekte të diplomacisë frënge*, 266.

Novipazari, dhe Shkodra; 7. Për t'i plotësuar nevojat e korpuseve, të dhjetat, nizami (duhet bërë egzonisacionimin [marrjen] në shërbim ushtarak edhe nga të krishterët, si dhe një taksë për jo luftëtarët e cila do të mblidhet nga nënkomitetet, mu për këtë qëllim; 8. Forca ushtarake do të përdoret menjëherë pas përfundimit të Kongresit të Berlinit, dhe varësisht nga vendimet që do t'i merr rreth çështjeve kufitare, t'u bëhet thirrje Malit të Zi e Serbisë të tërhiqen në territore të veta, dhe pika 9. Parashihte dënimin me vdekje në çdonjërin nënkomitet për personat të cilët nuk i përgjigjën thirrjes së nënkomitetit për mobilizim ushtarak.¹⁰

Është për të theksuar se, Perandoria Osmane ishte shumë konservatore për çështjen shqiptare. Porta nuk pranonte kërkesën për bashkimin e vilajeteve shqiptare edhe pse kabineti qeveritar ishte dakorduar disa herë rreth këtij projekti. Raportet që vinin nga terreni tregonin se shqiptarët kishin objektiva më të mëdha se sa bashkimi i katër vilajeteve. Udhëheqësit e Lidhjes u përpoqën me çdo kusht ta bindin Portën që të lejonte formimin e Lidhjes Shqiptare, si një organizatë kombëtare që luftonte për ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë.¹¹ Kërkesa për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një vilajet kishte kaluar me vendimin e Portës së Lartë, por nuk ishte aprovuar nga Sulltani, i cili i vënë nën presionin e Fuqive të Mëdha dhe, duke mos qenë i sigurt edhe për vetë fronin e tij, nuk qe në gjendje të merrej me çështjen e Lidhjes.¹² Në fakt, Sulltani nuk i ndali lojërat e tij politike për të përçarë krerët e Lëvizjes, duke përhapur mendimin se shqiptarët nuk mundin të mbrojnë tokat e tyre pa ndihmën e Perandorisë, duke përdorur si argument politikën ekspansioniste të vendeve fqinjë që e kishin shprehur në programet e tyre politike.¹³

Nga ana tjetër, politika angleze kishte dërguar porosi të qarta se do ta mbronin Perandorinë Osmane dhe ajo në fazën e parë të krizës ajo do të mbanë qëndrim turkofile. Politika Britanike në krye me Dizraelin ishte konservative për ndryshimet e reja. Një politikë të tillë e ndiqte edhe Bismarku, që shtynte Rusinë në luftë kundër Perandorisë Osmane, e cila do të dobësohej ndërkohë që Austro-Hungaria do të krijonte mundësin e dominimit në Gadishullin Ballkanik. Serbia dhe Mali i Zi ishin përgatitur prej kohësh në rrugëtimin e tyre ushtarako-politik për sulmin mbi tokat shqiptare, edhe pse krerët e Lëvizjes tentonin t'i iknin luftës së armatosur me vendet ballkanike dhe shpresonin të gjenin zgjidhje me vendet fqinjë në Ballkan. Në bazë të memorandumeve, sidomos të atij të 30 majit 1878,

¹⁰ Archives du Ministère des Affaires Étrangères, dokumenti, vol. XXI, N° 222 (14/07/1878), Paris 1878-1881 (konsullata e Francës në Shkodër), cit. sipas, Gjyltekin Shehu. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente diplomatike franceze: (1878-1881)*, 36-37, dok. 18.

¹¹ Nuray Bozbor. Politika e Abdyl Hamitit II me Lidhjen e Prizrenit, 229-230.

¹² Kristaq Prifti. *Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin kombëtar shqiptar (1878-1881)*, in: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i saj në histori* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2008), 21-41.

¹³ Nuray Bozbor. Politika e Abdyl Hamitit II me Lidhjen e Prizrenit, 229-230.

programi i Komitetit të Stambollit kërkonte që të jetohej në paqe me vendet fqinjë, por në të njëjtën kohë të mbrohej vendosmërisht territori shqiptar.¹⁴

Shqiptarët prisnin që në Kongresin e Berlinit, i cili do të mbahej me 13 qershor 1878, të bëhej rishikimi i vendimeve të Paqes së Shën Stefanit. Në anën tjetër, krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare vendosën që të thirrin Kuvendin e Përgjithshëm të Shqipërisë, i cili themeloi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878.¹⁵ Vendimet e para të saj janë marrë pas një jave, më 17 qershor, dhe ato janë përfshirë në librin e vendimeve dhe në “Udhëzimet” ose “Urdhëresat” (Talimat).¹⁶

Shtypi britanik, duke u marrë me vendimet e Shën Stefanit, vendimet e Kongresit të Berlinit dhe pasojat e tyre, kur flet për themelimin e Lidhjes së Prizrenit, vë në dukje se në prill të vitit 1878, shqiptarëve të Plavës dhe Gucisë iu bashkuan edhe banorë nga krahinat e tjera të Veriut, nën udhëheqjen e Ali Pashës, që formuan Besëlidhje për të kundërshtuar aneksimin e trojeve të tyre dhe dërguan misionarë në Prishtinë, Prizren, Ohër, Podgoricë e ndonjë vend tjetër, duke u bërë thirrje që t’u bashkohen atyre.¹⁷

Nga letërkëmbimi në mes të Konsullit grek në Shkodër, Mavrommatis dhe Ministrin të Jashtëm grek, vihet në pah se “Lidhja kishte filluar veprimtarinë e saj që para qershorit, kur u bë e njohur”. Në këtë letërkëmbim, Konsulli e përshkruan shtrirjen e Lidhjes “që nga veriu i Shkupit, drejt Prizrenit, Prishtinës, Gjakovës, Gucisë, Pejës, Shkodrës, fiseve malësore deri në Mat, Elbasan, Dibër, Kavajë, Tiranë, Peqin, Krujë dhe Durrës, që ishin lidhur në besë”. Detyrë themelore e Lidhjes ishte organizimi i rezistencës së armatosur, për të mbrojtur territoret shqiptare nga pushtimi ushtarak bullgar, serb dhe malazet. Qendra e saj duhet të ishte në një qytet që ndodhej në afërsi të këtyre fronteve. Nga kjo pikëpamje, kjo qendër duhet të ishte vetëm në Kosovë. Brenda kësaj treve, pozitën më të përshtatshme e kishte Prizreni i cili ishte, në të njëjtën kohë, një nga qytetet më të mëdha të Shqipërisë. Përveç kushteve të favorshme gjeografike dhe urbanistike, për ta vendosur qendrën në Prizren ndikoi edhe një faktor i rëndësishëm politik. Shovinistët e Beogradit pretendonin se Prizreni ishte qytet

¹⁴ Joseph von Hammer. *Historija Turskog (Osmanskog) carstva* (Zagreb: 1979), 484; Daily Telegram, The Exeter and Plymouth Gazette Daily Telegram, September 17th 1878; Shkëlzen Raça. *Marrëdhëniet shqiptaro-greke: 1829-1881* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës), 141; Gjyltekin Shehu, *Aspekte të diplomacisë frënge përkatazi me Lidhjen Shqiptare (1878-1881)*, 265.

¹⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, 154; Nuray Bozborra. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, përkthim nga gjuha turke, D. Egro (Tiranë: Shtëpia botuese “Dituria”, 2002); Neol Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha Ditore-Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 229.

¹⁶ Gazmend Shpuza, *Mbledhja e Kuvendit të Prizrenit dhe aktet e para të tij*, in: Studime Historike, Nr.3-4, (Tiranë: Instituti i Historisë, 1998), 40.

¹⁷ The British Library Board, Pall Mall Gazette-Wednesday, 9 April 1879.

i tyre, meqenëse gjatë shekullit XIV kishte qenë për disa dhjetëvjeçarë kryeqytet i shtetit mesjetar serb. Themelimi i Lidhjes Shqiptare në këtë qytet me popullsi dërmuese shqiptare, për të mbrojtur trojet shqiptare kundër lakmive sllave, ishte një goditje ndaj pretendimeve shoviniste serbe.¹⁸

Sipas statistikave osmane në katër vilajete jetonin rreth dy milion e gjysmë banorë, ku pjesën më të madhe e përbënin shqiptarët me 44%. Më pastaj vinin bullgarët e Maqedonisë së sotme më 12%, serbët 11.4%, grekët 9.2%, vllahët 6.5%, turko-osmanët 9.3%, çifutët, armenët dhe ciganët 0.4 % (...). Ndërsa, në aspektin e strukturës fetare 52.8 i përkisnin komunitetit mysliman, 27.8 ortodoks, 15% ekzarkist, 4% katolikë.¹⁹ Është për t'u theksuar se regjistrimet osmane të kohës mohonin kombësinë shqiptare, duke marrë në konsideratë me rastin e regjistrimit vetëm përkatësinë fetare. Intelektualët shqiptarë, se bashku me atdhetarët e kohës, u përpoqën të takoheshin me Sulltanin për të biseduar për ngjarjet dramatike që po vinin, por nuk e arritën këtë objektiv. Atëherë Abdyl Frashëri, Iljaz Pashë Dibra, Sheh Mustafë Tetova, Ali Bej Guçia, Ahmet Korenica udhëtuan drejtë Kosovës dhe, së bashku me delegatët e Janinës, u nisen drejt Prizrenit.²⁰ Ndërkohë Porta e lartë ishte e interesuar t'i kundërvihej Traktatit të Shën Stefanit, ç'ka e bënte më të lehtë detyrën e Lidhjes. Por, rrymat politike pro-turke nuk kishin hequr dorë nga presionet politike që Lidhja e Prizrenit të kthehej në funksion të politikës pro-osmane, që përmes saj të mbronin interesat e tyre. Rryma sulltanore gjatë gjithë kohës kërkonte të ishte vendimmarrëse në Kuvend dhe fryma kombëtare të zëvendësohej me frymën fetare, në mënyrë që çështja e mbrojtjes së hapësirës etnike shqiptare, të shndërrohej në çështje të mbrojtjes së territoreve mbi baza fetare që shkonin në favorin e Perandorisë, siç ishte rasti me Bosnjën dhe Hercegovinën. Kjo ndasi brenda lëvizjes kombëtare do të ishte njëri nga gabimet e mëdha të saj.²¹

Një pjesë e diplomacisë evropiane dhe asaj ballkanike²² i kushtuan vëmendje formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Nga raportet e konsujve austro-hungarezë Jelenik (Prizren), Lippih (Shkodër), Knapic (Manastir); të konsujve britanikë Grin (Shkodër), Suma (Shkodër), Blanti (Larisa); të konsujve grekë Mavromatis (Shkodër), Vatikotis (Selanik), Logothetis (Manastir); të konsujve franceze Ponis (Shkodër), Moro (Janine),²³ del se mbledhja e mbajtur

¹⁸ Kristo Frashëri. *Lidhja e Prizrenit dhe çështja kombëtare*, (bot. i 1989).

¹⁹ Hanns Dieter Schanderl. *Die Albanienpolitik Österreich-Ungarns und Italiens 1877-1908*, in: Albanische Forschungen Bd. 9, (Wiesbaden: 1971), 9-10.

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, 154.

²¹ Frashëri, *Lidhja e Prizrenit dhe çështja kombëtare*, (bot. i 1989), 208.

²² Bernard Stulli. Albasko Pitanje 1875-1882. Rad, ... st. 322.

²³ Kristo Frashëri. *Lidhja e Prizrenit dhe çështja kombëtare shqiptare në ditët e sotme*, Tiranë, 1989.

në Prizren vendosi që të krijonte një organizatë për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar me një Komitet Qendror që do ta kishte qendrën në Prizren. Duke folur rreth vendimeve të Lidhjes, korrespondenti britanik i gazetës “Manchester Guardian” që kishte udhëtuar nga Ragusa përmes Shkodrës deri afër Gjakovës, theksonte se “Lidhja i mbylli raportet me qeverinë osmane, duke kërkuar njëzëri një Shqipëri të pavarur”.²⁴

Raportimet e konsujve për Lidhjen kishin karakter shumë kontradiktor njëri me tjetrin dhe duhen parë në kontekstin e interesave të shteteve të veçanta. Sami Frashëri në një shkrim të botuar në gazetën turke “Terxhuman-i Shark”, nr. 107 rreth misionit të Lidhjes Shqiptare, shkruante: “Porta e Lartë, nuk ka fare gisht në Lidhjen Shqiptare, madje shumë vonë është informuar për ekzistencën e saj. Lidhja Shqiptare mbështetet në opinionin publik (shqiptar) dhe në qëllimin e lartë patriotik që të mos lejojë të bien në duart e të tjerëve ato toka që janë pjesë (përbërëse) e Shqipërisë e që banohej nga shqiptarë”.²⁵

Bibliografi:

- Aktenstücke aus den Korrespondenzen des Kais. und Kön. Gemeinsamen Ministeriums des Äusseren über orientalische Angelegenheiten Vom 7. Wien, 1877.
Archivio Storico Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri (Roma), *seria Politica* 1867-1888.
Hammer, von Joseph: *Historija Turskog (Osmanskog) carstva*, Zagreb, 1979.
Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II, Tiranë, 2001.
Malcolm, Noel: *Kosova, një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2001.
Prifti, Kristaq: *Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin kombëtar shqiptar (1878-1881)*, Prishtinë, 2008.
Raça, Shkëlzen: *Marrëdhëniet shqiptaro-greke 1829-1881*, Prishtinë, 2005.
Rizaj, Skënder: *Dokumente Angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e copëtimit të Ballkanit 1877-1885*, Prishtinë, 1996.
Shehu, Gjyltekin: *Aspekte të diplomacisë frënge përkatazë me Lidhjen Shqiptare (1878-1881)*, në: *Konferenca Shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, I*, Prishtinë, 1981.
Shehu, Gjyltekin: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente diplomatike franceze*, Prishtinë, 1981.
Shpuza, Gazmend: “Mbledhja e Kuvendit të Prizrenit dhe aktet e para të tij”, në: *Studime Historike, Nr. 3-4*, Tiranë, 1998.

²⁴ British Library Board Manchester Guardian, 14 Gusht 1880. London, UK.

²⁵ Sami Frashëri. Kush e prishpaqen, 23.

